

Shërbimet në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike

Prodhimi, trajtimi, transmetimi dhe furnizimi me ujë të pijshëm.

Mbledhja, largimi dhe trajtimi i ujërave të ndotura.

Mbledhja dhe largimi i ujërave të shiut dhe mbrojtja nga përmytjet në zonat e banuara.

Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore.

Ndriçimi i mjediseve publike.

Transporti publik vendor.

Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e varrezave publike, si dhe garantimi i shërbimit publik të varrimit.

Shërbimi i dekorit publik.

Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike.

Mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake.

Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale.

Administrimi dhe rregullimi i sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe.

Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor dhe zhvillimi i aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e shëndetit, si dhe administrimin e qendrave e të shërbimeve të tjera në fushën e shëndetit publik, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Planifikimi, administrimi, zhvillimi dhe kontrolli i territorit, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Instrumentet për administrimin e shërbimeve publike

Njësitë e vetëqeverisjes vendore sigurojnë dhënien e shërbimeve publike, nëpërmjet një ose më shumë instrumenteve të mëposhtme:

a) njësive organizative të veta, që janë pjesë e strukturës administrative të njësisë vendore;

b) ndërmarrjeve për shërbimet publike, sipas legjislacionit në fuqi;

c) kontraktimit të dhënies së shërbimeve me palë të treta;

ç) përdorimit të instrumenteve të përshtatshme të partneritetit publik dhe privat, sipas legjislacionit në fuqi;

d) krijimit të shoqërive tregtare në pronësi apo bashkëpronësi të njësisë vendore, sipas legjislacionit në fuqi.

Në çdo rast, pavarësisht nga instrumenti i përzgjedhur, njësia vendore do të jetë përgjegjëse për:

a) hartimin dhe vendosjen e një sistemi administrimi të performancës së shërbimit, bazuar mbi standarde vendore dhe/ose standarde minimale kombëtare;

b) hartimin dhe vendosjen e një sistemi treguesish, përfshirë edhe aspektin gjinor për matjen e performancës;

c) krijimin e një njësie të posaçme në strukturën e njësisë së vetëqeverisjes vendore, e cila do të jetë përgjegjëse për prezantimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e performancës e të shërbimit, përfshirë edhe aspektin gjinor.

Njësia e vetëqeverisjes vendore mund të ofrojë mbështetje financiare për ndërmarrjet bashkiake për shërbimet publike dhe/ose për shoqëritë tregtare me kapital të njësisë së vetëqeverisjes vendore, fusha e veprimit të së cilës lidhet me dhënien e një shërbimi publik që është përgjegjësi e kësaj njësie.

Instrumenti për administrimin e shërbimit funksionon si Sistem i monitorimit mbi bazën e objektivave dhe indikatorëve të performancës të miratuar në planet lokale të shërbimeve .

Sistemi i administrimit të performancës së shërbimit bazohet mbi standardet në hartimin e relacioneve mujore të realizimit të performancës së shërbimit të përcaktuar. Struktura përgjegjëse për prezantimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e performancës së shërbimit, përfshirë edhe aspektin gjinor është pjesë e organikës së strukturës së bashkisë.